



URDHËR
PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT (Q.K.B)

Për dijëni: debitorit Shoqëria "Hec Lashkiza" sh.p.k

kreditorit Shoqëria "Kelvin Konstruksion" sh.p.k

Unë Besnik Bajraktari, me detyrë përmbarues gjyqësor privat pranë shoqërisë përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k, me numër identifikimi L51526008U, nr. liçence 56, datë 21/09/2010, pasi studiova dosjen përmbarimore nr. 690 datë 28.01.2021, që i'u përket palëve me:

Kreditor : Shoqëria "Kelvin Konstruksion" sh.p.k

Debitor : Shoqëria "Hec Lashkiza" sh.p.k

Objekt : Pagim detyrimi

KONSTATOVA :

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit nr. 1895 regj. them. datë 27.01.2021, për zbatimin e titullit ekzekutiv faturë tatimore shitje nr. 85 nr. serie 25647335 datë 01.09.2020 si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit nr. 1896 regj. them. datë 27.01.2021, për zbatimin e titullit ekzekutiv faturë tatimore shitje nr. 84 nr. serie 25647334 datë 01.08.2020, në bazë të cilit debitori shoqëria "Hec Lashkiza" sh.p.k është i detyruar të paguajë në favor të kreditorit Shoqëria "Kelvin Konstruksion" sh.p.k detyrimin që rrjedh sipas faturave tatimore, tarifën përmbarimore si dhe kamat vonesat ligjore sipas Ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare", deri në ekzekutimin e plotë të vendimit të gjykatës. (Udhëzimi nr. 385/7 datë 28.06.2017).

Në referim të nenit 517 të K.Pr.Civile, janë kryer procedurat për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, por debitori nuk ka përmbushur këtë detyrim në afatin e caktuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në referim të neneve 519, 527 të K.Pr.Civile

URDHEROJ :

1.Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet/kuotat e regjistruara në emër të debitorit Shoqëria "Hec Lashkiza" me NIPT L21917008H.

2.Per veprimet ose mosveprimet tuaja, duhet të na vini në dijeni, brenda 5 diteve nga marrja e këtij njoftimi.

3.Ne rast të kundert, ndaj personave shkaktare, do të aplikojmë gjobe në masën 50 000 leke, në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile.

